

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit K. Ç., nga Prizreni, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.1895/15 të datës 25.10.2016, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 paragrafi 1 të KP-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së, për dhënien e urdhrit ndëshkimor me datë 14.07.2017, morri këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**K. Ç.**, nga i ati A.-Q., dhe nëna N. e lindur K., i lindur me datë *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton, rruga ....., ka të kryer shkollën e mesme, tregtar, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë 16.06.2015 rreth orës 11,50 minuta, në Prizren, saktësisht në korridorin e Gjykatës Themelore në Prizren, seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privoj nga jeta, të dëmtuarin F. Ç. – vëllaun e tij, në atë mënyrë që pas seancës së mbajtur në Gjykatë lidhur me pronën e trashëguar nga babai i tyre, të njëjtit takohen në korridor, ku i pandehuri e kanos me fjalët “po të pres në lokal kam me të thyer dh ke me mbet sakat tërë jetën”, me ç’ rast me këto veprime tek i dëmtuari shkakton ankth dhe frikë si dhe ia rrezikon sigurinë personale,

- këso dore ka kryer veprën penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KP-së,

- Andaj, gjykata me aplikimin e dispozitave të nenit 4, 41, 43 par. 1 pika 1.3, nenit 46, 73 të KPK-ës dhe neni 495 të KPPK-ës jep:

### U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

- **PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.1895/15 të datës 25.10.2016, ashtu që.

Të akuzuarit **K. Ç.**, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 200 € (dyqind) euro, të cilin dënim i akuzuari duet të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur për çdo 20 € një ditë burg.

I dëmtuari: F. (A.) Ç., nga Prizren, rruga ....., për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor shumen prej 20,00 euro, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate, i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1895/15 të datës 25.10.2016, kundër të akzuarit K. Ç., nga Prizreni, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KP-së, dhe kërkesën për lëshimin e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetim se janë siguruar të dhëna të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale i cila i vihet në barë dhe janë plotësuar kushtet ligjore kon forme nenit 493 të KPPK-ës për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit të kërkesës të PTH-ës në Prizren për dhënien e urdhrin ndëshkimor konstatoi se ka të dhënat mjaftueshme të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor, andaj gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore dhe mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kjo gjykatë konsideron se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë; nga deklarata e të dëmtuarit dhe të pandehurit të dhënë në procedurën paraprake, si dhe në shkresat e tjera të lëndës vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale i cila i vihet në barë.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në nenin 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 të KPP-ës.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në neni 463 par.1 të KPP-ës,

Me sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimit

### **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN P.nr.2298/2016 të datës 14.07.2017.**

**Procesmbajtësja  
Naxhis Sharani**

**Gjyqtari i vetëm gjykues  
Luan Berisha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit, në këtë gjykatë. Po qesë i pandehuri nuk ushtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.